

FACE - Familjet dhe fëmijët në arsim është një projekt i bashkëfinacuar nga Universiteti i Cyrihut për përgatitjen e mësuesve (Shkolla e Lartë Pedagogjike e Cyrihut) dhe nga Departamenti i Financave i Kantonit të Cyrihut, Zvicër.

Libri i punës FACE 1 - Forcojmë vetëbesimin dhe luajmë së bashku. Moshë 4 deri 6 vjeç

Libri i punës FACE 2 - Forcojmë vetëbesimin dhe festojmë së bashku. Moshë 7 deri 9 vjeç

Libri i punës FACE 3 - Forcojmë vetëbesimin dhe punojmë së bashku. Moshë 10 deri 12 vjeç

Autorja: Wiltrud Weidinger

Bashkautorë: Sabrina Marruncheddu, Peter Holzwarth

Grafika dhe Layout: Nadine Hugli

Redaksia: Franziska Agosti

PH IPE - INTERNATIONAL
ZH PROJECTS IN
EDUCATION
ZURICH UNIVERSITY
OF TEACHER
EDUCATION

Publikuar më 2017

Universiteti i Cyrihut për përgatitjen e mësuesve, Qendra IPE.


www.phzh.ch/ipe

FACE

Wiltrud Weidinger

FORCOJMË VETËBESIMIN DHE FESTOJMË SË BASHKU

Mosha 7 deri 9 vjeç



SI TË PUNOHET ME KËTË LIBËR

Mirë se vini tek FACE – Familjet dhe fëmijët në arsim.

Ky libër ju përket juve. Është një libër pune për ju për t'i përmirësuar fuqitë tuaja si edhe ndjenjat tuaja në lidhje me veten. Me këtë libër do të punoni në shkollë bashkë me shokët tuaj dhe me mësuesin. Këtu do të ketë detyra që ju mund t'i zgjidhni vetë si edhe detyra që mund t'i zgjidhni me një shok a shoqe.

Në librin FACE do të gjeni dy fëmijë, të cilët do t'i shkojnë librit së bashku me ju. Ata ndonjëherë do t'ju tregojnë diçka në një fotografi. Ndonjëherë ata vetëm do të jenë aty derisa ju punoni.

Ja ku janë:





Çfarë përmban libri?

Në këtë libër do të punoni përmes shtatë njësive mësimore. Në çdo njësi mësimore ka një temë të cilën mësuesi duhet ta bëjë bashkë me ju. Ndonjëherë do të shkruani diçka, ndonjëherë do të vizatoni, ndonjëherë do të diskutoni dhe do të bisedoni në lidhje me diçka, dhe, ndonjëherë do të bëni diçka. Për çdo detyrë ose mund të lexoni se çfarë duhet të bëni ose mund të pyesni mësuesin tuaj.

Në fund të çdo njësie mësimore do të merrni një detyrë shtëpie që mund ta bëni me ndihmën e familjes suaj. Mësuesi do t'ju tregojë se çfarë duhet të bëni.

Në FACE nuk ka "mirë" apo "keq". Nuk ka gabime!

Tash, para se të filloni: shkruani emrin tuaj në kopertinë e librit që ta dini se është i juaji.

E shkruat? Shumë mirë!

Le të fillojmë! Mirë se vini tek FACE – Familje dhe fëmijë në arsim

PËRMBAJTJA

1 Për mua

Faqe 6–17

1 – Detyra 1	Ky-kjo jam unë	8
1 – Detyra 2	Ku bëj pjesë	10
1 – Detyra 3	Gishtërinjtë më bëjnë të veçantë	11
1 – Detyra 4	Dora ime e pëlqimeve	13
1 – Detyrë shtëpie 5	E kujt është kjo dorë?	15
1 – Detyra 6	Ky-kjo është pjesëtar i familjes sime	16

2 Ndjenjat e mia

Faqe 18–33

2 – Detyra 1	Faqja ime e lumtur dhe e trishtuar	20
2 – Detyra 2	Si ndihem kur...	22
2 – Detyra 3	Ndjenjat e mia- ndjenjat e tua	24
2 – Detyra 4	Ndryrja e frikës sime	27
2 – Detyrë shtëpie 5	Familja ime është e lumtur kur...	31
2 – Detyra 6	Paraqes ndjenjat e familjes sime	33

3 Çfarë mund të bëj

Faqe 34–47


3 – Detyra 1	Çfarë patë sot?	36
3 – Detyra 2	Forca e këmbës sime	38
3 – Detyra 3	Ylli i aftësive të mia	40
3 – Detyra 4	Mund të bëj shumë... me një copë spango	42
3 – Detyrë shtëpie 5	Ne jemi të zotët për shumë gjëra	44
3 – Detyra 6	Familja ime është e zonja për këto gjëra	46

4 Unë dhe shokët e mi

Faqe 48–61

4 – Detyra 1	Gjërat që më pëlqejnë	50
4 – Detyra 2	Çfarë nuk pëlqejmë	52
4 – Detyra 3	Ushqimi im i parapëlqyer	55
4 – Detyra 4	Luaj me shokët e mi	57
4 – Detyrë shtëpie 5	Ky-kjo jam unë kur isha i/e vogël	59
4 – Detyra 6	Paraqes veten, kur isha i/e vogël	61

5 Familja ime		Faqe 62–75
5 – Detyra 1	Familjet janë të ndryshme	64
5 – Detyra 2	Përse një familje është e rëndësishme	66
5 – Detyra 3	Detyrat në familjen time	68
5 – Detyra 4	Fëmijëve u duhen rrënjë, u duhen krahë	70
5 – Detyrë shtëpie 5	Pema e familjes sime	72
5 – Detyra 6	Paraqes pemën e familjes sime	74
6 Festojmë bashkë		Faqe 76–85
6 – Detyra 1	Çfarë mund të paraqesim?	78
6 – Detyra 2	Praktikojmë (1)	80
6 – Detyra 3	Shkruajmë një ftesë	82
6 – Detyra 4	Praktikojmë (2)	84
6 – Detyrë shtëpie 5	Ftoji prindërit e tu	85
7 Çfarë kam mësuar – çfarë kemi mësuar		Faqe 86–95
7 – Detyra 1	Pyetje dhe përgjigje për veten	88
7 – Detyra 2	Momentet e mia të lumtura dhe të trishtuara	90
7 – Detyra 3	Detyra ime e parapëlqyer	92
7 – Detyra 4	Çmimi im personal	94
Përshtypjet e mësuesit tim		96



PËR mua

1



1 - Detyra 1

KY-KJO JAM unë



45'

Detyra:

Shkruaj gjërat më të rëndësishme për veten.

Si punon:

Vetëm, më pas me të gjithë grupin.

Materiali:

- Libri
- Lapsa, ngjyra


Hapat:

1. Në fillim puno vetë dhe mbush fletën e punës "Për veten".
2. Më pas vizatoje veten.
3. Kur të kesh përfunduar, lëre librin të hapur mbi tryezën tënde dhe ec përreth e shiko punët e të tjerëve.




Për mua

EMRI IM ËSHTË



unë JAM  **VJEÇ**

Vizatoje veten. Ngjyrose me ngjyrat që parapëlqen.
Në sfond vizato gjëra që të pëlqejnë.



1 - DETYRA 2

KU BËJ PJESË



30'

Detyra:

Kupton që secili është ndryshe.

Si punon:

Me të gjithë grupin.

Materiali:

- Asgjë

Hapat:

1. Mësuesi vizaton një vijë mbi dyshe me ose tregon se ku duhet të imagjinoni një vijë (ose shënon një vijë me shirit ngjitës).
2. Çdo nxënës qëndron mbi vijë.
3. Mësuesi jep kategori të ndryshme. Nxënësit që qëndrojnë në vijë përshtaten me kategoritë. P. sh. për kategorinë "nga më i gjati deri tek më i shkurtri", nxënësit rregullohen sipas gjatësisë. Më të gjatët qëndrojnë në një anë të vijës dhe më të shkurtrit në anën tjetër të saj.
4. Mësuesi vazhdon me kriteret e reja:
 - Nga ata me këmbë më të madhe tek ata me këmbë më të vogël.
 - Nga më i madhi tek më i vogli
 - Nga ata me flokë më të gjatë tek ata me flokë më të shkurtër.
 - Nga ata me më shumë motra e vëllezër tek ata pa motra e pa vëllezër
 - etj.
5. Nxënësit mund të japin edhe sugjerimet e tyre për kriterie.



1 - DETYRA 3

GISHTËRINJTË MË BËJNË TË VEÇANTË



30'

Detyra:

E kupton që çdokush është i ndryshëm dhe se gjurmët e gishtërinjve tuaj janë unike.

Si punon:

Vetëm, më pas me të gjithë grupin.

Materiali:

- Libri
- Bojëra ose jastëk ngjyre
- Fletë gazete nëse duhen.

Hapat:

1. Përdor një jastëk ngjyre apo ngjyra për të ngjyrosur gishtërinjtë e tu.
2. Lëri gjurmët e gishtërinjve në faqen tjetër.
3. Asnjëri në botë nuk mund të ketë tamam të njëjtat gjurmë gishtërinjsh si ti.
4. Kur të kesh përfunduar, lëre librin të hapur mbi bankë.
5. Ec dhe vështro gjurmët e gishtërinjve tek të tjerët. Qëllimi i mësuesit është të tregojë ndryshimet midis gjurmëve të gishtërinjve.


Alternativë:

Nëse ka kohë dhe ka mbetur letër, nxënësit mund të lënë gjurmët e këmbëve të tyre. Më vonë duhet t'i lajnë sërish këmbët. Me të përfunduar, nxënësit mund të shikojnë gjurmët e këmbëve të të tjerëve. Është detyra e mësuesit të bisedojë me nxënësit për ndryshimet. Fëmijët shikojnë nëse mund "të lexojnë" fotografitë me gjurmë. Disa vija mund të duken si rrjet merimange, disa si shinat e trenit, disa mund të duken si guackë kërmilli apo si labirint etj.



Gishtërinjtë më bëjnë të veçantë

Dora e djathtë



Gishti i madh

Dora e majtë



Gishti i madh

1 - DETYRA 4

DORA IME E PËLQIMEVE



30'

Detyra:

Mëson se çfarë pëlqejnë të tjerët tek ti.

Si punon:

Vetëm, më pas me një shok.

Materiali:

- Broshura
- Lapsa, ngjyra

Hapat:

1. Shkruaj emrin në kyçit të dorës në faqen tjetër.
2. Thuaj pesë shokëve e shoqeve të shkruajnë diçka që ata pëlqejnë tek ti, në çdo gisht.
3. Lexo se çfarë kanë shkruar. Je dakort?
4. Ngjyros dorën pa ngjyrosur fjalët.
5. Ec nëpër klasë dhe vështro duart e të tjerëve.



Dofa ime e pëlqimeve

1 – Detyrë shtëpie 5

E kujt është kjo dorë?



Detyra:

Bëje një gjurmë dore të njërit prej pjesëtarëve të familjes dhe sille në shkollë.

Si punon:

Bashkë me familjen

Materiali:

- Letër
- Bojë

Hapat:

1. Gjej një pjesëtar të familjes sate.
2. Merr gjurmët e duarve të këtij personi. Ngjyrose dorën me bojë dhe vëre në letër të zbrazët. Nëse nuk ke bojë, mund të bësh gjurmë të dorës me një laps me ngjyrë dhe ta ngjyrosësh atë.
3. Thaje atë dhe mos harro ta fusësh në çantën e shkollës.



1 - Detyra 6

KY-KJO ËSHTË Pjesëtar I Familjes Sime



70'

Detyra:

Paraqet një pjesëtar të familjes sate tek shokët e klasës.

Si punon:


Vetëm, me të gjithë grupin, me një shok.

Materiali:



- Libri
- Lapsa me ngjyra, lapsa




Hapat:

1. Vendos mbi bankë gjurmët e duarve të pjesëtarit të familjes.
2. Ec nëpër klasë dhe vështro të gjitha gjurmët e duarve të të tjerëve.
 - Mund të gjesh se gjurmët e kujt janë?
 - Të mamasë? Të babait? Të motrës? Të vëllait? Të gjyshit e të gjyshes?
 - Sa gjetët saktë?
3. Tani, vizato personin duart e të cilit janë. Përdor kornizën në faqen tjetër.
4. Ngjyrore atë dhe shëno poshtë emrin se kujt i përket.
5. Tregoja shokut tënd dhe shpjegoja atë.



Një pjesëtar i familjes sime





NDJENJAT e mia

2



2 - DETYRA 1

FAQJA IME E LUMTUR DHE E TRISHTUAR



30'

Detyra:

Mendo se çfarë të bën të lumtur dhe çfarë të bën të trishtuar.

Si punon:

Vetëm

Materiali:

- Libri
- Lapsa, ngjyra.

Hapat:

1. Skico faqen tënde të lumtur dhe të trishtuar. Mendo për gjërat që të bëjnë të lumtur dhe për gjërat që të bëjnë të trishtuar.
2. Shkruaj apo vizato këto gjëra mbi secilen anë të faqes.
3. Kur je i trishtuar, mendo se si mund të ndryshosh situatën dhe se si mund të gjesh zgjidhje, p.sh. "Unë jam e trishtuar sepse shoku im nuk do të luajë me mua. Kështu do ta pyes dikë tjetër të luajë me mua".
4. Ti vendos, nëse do t'ua tregosh faqet e tua shokëve të tu të klasës.



Faqja ime e LUMTUR



Faqja ime e TRISHTUAR



Ngandonjëherë kur jam i trishtuar mund të ndryshoj ndjenjat.
Për shembull:

2 – DETYRA 2 SI NDIHEM KUR...



30'

Detyra:

Përshkruaj se si ndihesh në situata të ndryshme.

Si punon:


Vetëm, më pas me të gjithë grupin.

Materiali:

- Libri
- lapsa

Hapat:

1. Lexo fjalitë në faqen tjetër ose lëre mësuesin apo një shok që t'i lexojë.
2. Imagjino se si duket fytyra për secilën situatë.
3. Vizato nga një fytyrë që përshtatet me çdo situatë.
4. Pasi secili të këtë përfunduar, mësuesi do të vizatojë fytyra boshe mbi dërrasë apo mbi një copë letër. Mësuesi do të kërkojë për përgjigjet tuaja.
5. Ngreje dorën nëse do të vizatosh fytyrën përpara klasës apo nëse do t'i tregosh kujtdo fytyrën që ke vizatuar në librin tënd.
6. Imitoje fytyrën që u vizatua përpara klasës dhe lëre klasën po ashtu ta imitojë.




Si ndihem, kur...

Unë kam bërë një punë të mirë në shkollë.



Jam shtyrë nga një fëmijë tjetër.



Pranoj një dhuratë.



Jam në telashe, për diçka që nuk e kam bërë.



Kam lënduar veten.



Duhet të eci vetëm mospërmes rrugës së errët.



2 – DETYRA 3

NDJENJAT E MIA – NDJENJAT E TUA



30'

Detyra:

Pyet shokët e tu, se si ndihen në situata të ndryshme.

Si punon:

Me një shok.

Materiali:


- Libri
- Lapsa, ngjyra

Hapat:

1. Merre librin dhe ec nëpër klasë. Kur të takosh një nxënës tjetër bëji një prej pyetjeve në faqen vijuese.
2. Shkruaj përgjigjen e tij saj në tabelë. Mund të bësh edhe një vizatim. Mos harro të shkruash poshtë emrin e shokut tënd/ shoqes tënde.
3. Ai/ajo duhet t'ju bëjë gjithashtu një prej këtyre pyetjeve.
4. Kur të kesh përfunduar, mund të fillosh vetë detyrën tjetër.

Alternativa:

Nese e di këngën "Nëse e di që je i lumtur", mund ta këndosh këtu. Përshtatet shumë mirë me tematikën dhe po ashtu i bën fëmijët të lëvizin pak. Nëse ka lidhje interneti, mund të mësosh këngën në youtobe: www.youtube.com/watch?v=D9fd4vvpRqw



Ndjenjat e mia-ndjenjat e tua

Ndihem i lumtur kur...



Ndihem i trishtuar kur...



Ndihem i zemëruar kur...



Ndihem i vetmuar kur...



Ndihem i ngacmuar kur...



Ndihem i frikësuar kur...




Ndihem i relaksuar kur...



Nëse di që je i lumtur



Në se di që je i lum-tur për-plas du-art (kllap kllap) në-se di që je i lum-tur për-plas



du-art (kllap kllap) në - se di që je i lum-tur dhe fy - ty - ra ta tre-gon në - se



di që je i lum - tur për - plas du - art (kllap kllap)

Nëse di që je i lumtur, përplas duart (kllap, kllap)
Nëse di që je i lumtur, përplas duart (kllap, kllap)
Nëse di që je i lumtur dhe fytyra ta tregon,
Nëse di që je i lumtur përplas duart (kllap, kllap)

Nëse di që je i lumtur, përplas këmbët (pam, pam)
Nëse di që je i lumtur, përplas këmbët (pam, pam)
Nëse di që je i lumtur dhe fytyra ta tregon,
Nëse di që je i lumtur, përplas këmbët (pam, pam)

Nëse di që je i lumtur thuaj Urra, Urra
Nëse di që je i lumtur thrrit Urra, Urra,
Nëse di që je i lumtur dhe fytyra ta tregon,
Nëse di që je i lumtur thrrit Urra, Urra,

Nëse di që je i lumtur bëj të trija (kllap, kllap, pam, pam, urra, urra)
Nëse di që je i lumtur bëj të trija (kllap, kllap, pam, pam, urra, urra)
Nëse di që je i lumtur dhe fytyra ta tregon
Nëse di që je i lumtur bëj të trija (kllap, kllap, pam, pam, urra, urra)

2 – Detyra 4

NDRYRJE e FRIKËS sime



45'

Detyra:

Gjej mënyra si të kapërcesh frikën në disa situata.

Si punon:

Vetëm

Materiali:


- Libri
- Lapsa, ngjyra
- Shirit ngjitës
- Nëse është e mundur zarfa dhe fletë letre (për të vizatuar dhe fshehur frikën)

Hapat:

1. Shiko foton në faqen tjetër. Përse mendon se fëmija është i frikësuar?
2. Dëgjo historinë që mësuesi do t'jua lexojë.
3. Mendo për situatat në të cilat ke qenë i/e frikësuar. Si e ke kapërcyer frikën?
4. Vizato frikën tënde në libër. Pasi ta kesh vizatuar atë, mund përreth saj të vizatosh një valixhe, kështu që nga ky moment frika është e ndryrë atje.
5. Mund t'ia tregosh atë dikujt ose mund të mendosh se ku mund ta çosh valixhen.

Alternativa:

Nxënësit mund të vizatojnë frikën e tyre në fletët bosh dhe më pas në fund t'i fusin ato në zarfe. Në këtë mënyrë fëmijët mund të shpëtojnë me të vërtetë nga frika e tyre.





Shiko foton, pse është femija
kaq i frikësuar?

Dëgjoje tregimin

Një herë e një kohë na ishte një lepur. Të gjithë e thërrisnin atë "mace frikacake". Ai do të donte më shumë të ishte lepur trim. Por ai thjesht kishte gjithmonë frikë. Kur kishte stuhi dhe vetëtimat përplaseshin deri poshtë, ai gjithmonë fshihej tek mami. Kur vinin lepuj të tjerë dhe e ngacmonin, ai largohej duke qarë. Gjëja më e frikshme ishte kur binte errësira natën. Atëherë ai fillonte të shikonte monstra dhe fantazma kudo. Një mbrëmje i tha vetes, "Nuk dua të jem më mace e trembur. Dua të jem një lepur trim." Ky vendim e bëri atë tepër të lumtur. Më pas i tha vetes, "Sonte natën do të rri vetëm jashtë në errësirë. Po, do ta bëj". Mori pishtarin me vete dhe shkoi. Më pas u bë errësirë e më errësirë në pyll. Papritur lepur i bërtiti, "Çfarë është kjo? Duket si një monstër e madhe." Ai do të kishte dashur të shkonte menjëherë në shtëpi, por nuk donte të ishte më mace frikacake. Për fat iu kujtua pishtari i tij.

"Do të shoh monstrën më afër" pëshpëriti. Më pas iu kthye pishtarit dhe e drejtoi atë nga monstra. "Oh, nuk është fare monstër", psherëtiu. "Është vetëm një pemë e madhe e errët". Më pas fiku sërish pishtarin dhe vazhdoi të ecë.


Në qiell, hëna doli pas një reje të madhe të errët. Drita e hënës rrezatonte mes përmes pemëve. Lepuri i vogël vazhdoi të ecte tutje e tutje në pyll derisa arriti një pellg të vogël. Përgjatë brigjeve të tij mijëra gurë të vegjël guralecë që shndrisnin si perla nën dritën e hënës. Lepuri i vogël shikoi ujin dhe hënën e plotë që pasqyrohej në ujë. "Sa bukur duket gjithçka" mendoi. Pas një farë kohe ishte i gjithi i heshtur.

Papritur kishte frikë. "Një fantazmë, një fantazmë" bërtiti. "Këtu është një fantazmë në ujë. Po më shikon mua me sytë e saj të mëdhenj e të frikshëm". Lepuri pothuaj lagu veten, sepse ishte kaq i frikësuar. Kërceu lart dhe donte të largohej menjëherë, kur pa që edhe fantazma po ashtu kishte kërcyer lart.

Lepuri i vogël ndaloi dhe mendoi, "hëm, kjo fantazmë duket disi familjare me mua" Ai ngriti putrën e tij të djathtë. Po ashtu edhe fantazma ngriti dorën e saj të djathtë. Më pas lepuri luajti veshët e tij. Fantazma luajti po ashtu veshët. Më në fund lepuri nxorri jashtë gjuhën e tij në drejtim të fantazmës dhe tha "Baaah!". Po çfarë bëri fantazma? Ajo zgjati gjuhën dhe tha "Baaah!" po ashtu.

Më pas lepuri i vogël filloi të qeshë. Ai qeshi e qeshi derisa nuk mundi të pushonte më së qeshuri. "Kjo nuk është fare fantazmë", bërtiti. "Ky është pasqyrimi im në ujë! Ky jam unë, lepuri i vogël, i pasqyruar në ujë!" Më pas ai qeshi edhe më shumë. Për shkak të gjithë së qeshurës, filloi të kërcente nga një këmbë në tjetrën. Pasi me të qeshur kishte larguar frikën, vrapoi në shtëpi. U shtri në krevatin e tij dhe filloi të flinte shumë thellë.

Që nga ajo ditë, lepuri i vogël u bë trim e më trim. Çdo ditë e më shumë. Dhe shpejt asnjëri nuk e thërriste më asnjëherë "mace frikacake".





Vizato frikën tënde

Vizato në mes të letrës diçka nga e cila ke frikë.
Më pas vizato një valixhe përreth saj me një dorezë.
Tani ke mbyllur frikën tënde në valixhe.
A po shkon t'ia tregosh dikujt?
A po shkon ta çosh atë diku?

A large white rectangular area for drawing.

2 – Detyrë shtëpie 5

Familja ime është e lumtur kur...



Detyra:

Bëj një tabelë për ndjenjat e familjes sate në situata të ndryshme.

Si punon:

Në shtëpi apo në një vend të qetë.

Materiali:

- Libri
- Lapsa

Hapat:

1. Shiko në tabelë. Pyet pjesëtarë të ndryshëm të familjes.
2. Hidh përgjigjet në fletën e përgjigjeve.
3. Falëndero njerëzit për përgjigjet e tyre.



Familja ime është ...kur...

është i/e lumtur kur...

është i/e trishtuar kur...

është i/e zemëruar kur...

është i/e vetmuar kur...

është i/e relaksuar kur...

është i/e frikësuar kur...

Motra **HALLA/TEZJA**
XHAXHAI/DAJA
gjyshi **MAMAJA** **vëllai** **gjyshja**
PERSONA TË TJERË
TË RËNDËSISHËM **BABAI**

2 – DETYRA 6

PARAQES NDJENJAT E FAMILJES SIME



Detyra:

Paraqet në grup ndjenjat e familjes sate.

Si punon:

Në grupe dhe me të gjithë grupin.

Materiali:

- Libri

Hapat:


1. Shiko në faqen e ndjenjave të familjes (ana e majtë).
2. Rri në grup prej 4 vetash.
3. Zgjedhni një ndjenjë për të cilën do të flisni. Duhet të bini dakord në grupin tuaj.
4. Çfarë është ndryshe në përgjigjet e anëtarëve të familjeve tuaja?
5. Vendosni se kush do ta paraqesë para klasës.
6. Paraqit në klasë ndjenjat tuaja të zgjedhura.






ÇFARË MUND TË BËJ

3



3 - DETYRA 1 ÇFARË PATË SOT?



25'

Detyra:

Mendo për të gjitha gjërat që pe sot dhe shkruaji ose vizatoji ato.

Si punon:




Vetëm

Materiali:

- Libri
- Lapsa, ngjyra


Hapat:

1. Mendo për ditën tënde sot.
Çfarë pe kur u zgjove në mëngjes?
2. Çfarë pe kur u ngrite?
3. Çfarë pe kur shkove në shkollë?
4. Shkruaj apo vizato gjithçka.
Sa e gjatë është lista jote?



Çfarë pe sot?

RENDIT GJITHÇKA QË KE PARË SOT.



3 – DETYRA 2

FORCA E KËMBËS SIME



25'

Detyra:

Gjej se çfarë mund të bëjë këmba jote.

Si punon:

Vetëm, më pas me shokun tënd.

Materiali:

- Libri
- Lapsa, ngjyra

Hapat:

1. Shkruaj të gjitha gjërat që mund të bëjnë këmbët e tua. Mund t'i vizatosh ato.
2. Ec nëpër klasë dhe krahaso përfundimet e tua me ato të shokëve të klasës. A keni të gjithë ide të ngjashme? Qarko çfarë është e njëjtë.



FORÇA e këmbëve të mia



3 – DETYRA 3 YLLI I AFTËSIVE TË MIA



45'

Detyra:

Grumbullo të gjitha gjërat që mund të bësh në yllin tënd dhe paraqite atë mbi dyshemenë e klasës.

Si punon:

Vetëm, më pas me të gjithë grupin.

Materiali:


- Libri
- Lapsa, ngjyra

Hapat:

1. Ti je një yll. Shkruaj emrin tënd në mes të yllit.
2. Shkruaj në çdo rreze të yllit diçka që mund ta bësh mirë. Këto janë aftësitë e tua.
3. Nëse të nevojitet, mund të shtosh më shumë rreze tek ylli yt.
4. Ngjyrose yllin tënd brenda.
5. Kur të kesh përfunduar, vendos librin mbi dysheme në mes të klasës.
6. Ec nëpër klasë dhe shiko yjet e tjerë. Vlerësojini të gjithë yjet që keni në klasën tuaj. Diskutoni këtë me mësuesin.




Ylli i aftësive të mia



Ky është ylli
i aftësive të mia.

Aftësia ime e
parapëlqyer është:



3 – DETYRA 4

MUND TË BËJ SHUMË... me NJË COPË SPANGO



45'

Detyra:

Gjej gjëra të ndryshme që mund të bësh me një copë spango.

Si punon:

Vetëm, më pas me të gjithë grupin.


Materiali:

- Libri
- Lapsa, ngjyra
- Një copë spangoje për të gjithë nxënësit (30 cm për nxënë).

Hapat:

1. Merr një copë spango nga mësuesi yt (rreth 30 cm).
2. Mendo disa minuta për gjërat që mund të bësh me një copë spangp. Ndoshta mund të përpiqesh t'i bësh disa prej këtyre gjërave (për shembull: vizato një rreth në rërë).
3. Shkruaj gjithçka në listë.
4. Pasi të kesh përfunduar, merr librin dhe rri në rreth.
5. Mësuesi yt do të grumbullojë tani të gjitha idetë tuaja.
6. Sigurohu që të këmbesh idetë e listës sate me grupin.

Gjërat që mund të bëj
me një copë spango



3 – Detyrë shtëpie 5

Në jemi të zotët për shumë gjëra



Detyra:

Bëj një studim të gjërave që mund të bëjnë anëtarët e familjes sate. Numëro përgjigjet për talente të ndryshme.

Si punon:

Vetëm ose me një shok.

Materiali:

- Libri
- Lapsa

Hapat:

1. Përdor listën për të pyetur pjesëtarët e familjes sate se për cilat gjëra ata janë të zotët. Përpiqu të pyesësh sa më shumë njerëz të jetë e mundur.
2. Bëj një shenjë çdo herë kur dikush jep përgjigje. Pyete atë të të japë një shembull dhe shkruaje atë.
3. Në fund, shkruaj se për cilat gjëra je i zoti.
4. Numëro përgjigjet dhe shkruaj numrin.



Ne jemi të zotët për SHUMË GJËRA

SHEMBULL



NR.



Për të menduar, për të zgjidhur një problem.




Për të riparuar diçka.



Për të folur me njerëzit sy më sy.



Për të kënduar, për të kërcyer, për të luajtur një instrument.



Për të pikturuar, për të vizatuar.



Për të punuar me numrat.



Për të organizuar diçka.



Për të ndihmuar të tjerët.



Për të treguar histori.



3 – DETYRA 6

FAMILJA IME ËSHTË E ZONJA PËR KËTO GJËRA



45'

Detyra:

Bën një grafik të gjërave, për të cilat familja jote është e zonja

Si punon:


Vetëm, më pas me të gjithë grupin.

Materiali:

- Lapsa
- Lapsa me ngjyra
- Vizore

Hapat:

1. Merr tabelën me numrat dhe shëno numrat në grafik.
2. Bëj kolona me një vizore për aq pjesëtarë të familjes që janë të zotët në diçka.
3. Ngjyros kolonat me ngjyra të ndryshme.
4. Rrini në rreth dhe vendosni se kush dëshiron të ndajë një apo disa gjëra, për të cilat familja e tij/e saj është e zonja.



KËTO JANË GJËRAT

për të cilat familja ime është e zonja


	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Për të menduar, për të zgjidhur një problem.										
Për të riparuar diçka.										
Për të folur me njerëzit sy më sy.										
Për të kënduar, për të kërcyer, për të luajtur një instrument.										
Për të pikturuar, për të vizatuar.										
Për të punuar me numrat.										
Për të organizuar diçka.										
Për të ndihmuar të tjerët.										
Për të treguar histori.										

Familja ime është
më e zonja për...

Unë jam më
i zoti për...



Unë dhe shokët e mi



4 – DETYRA 1 GJËRAT QË MË PËLQEJNË



45'

Detyra:

Vizato apo shkruaj gjëra që i pëlqen.

Si punon:


Vetëm, më pas me të gjithë grupin.

Materiali:

- Libri
- Lapsa, ngjyra

Hapat:

1. Mendo për të gjitha gjërat që të pëlqejnë.
2. Vizatoji apo shkruaji ato në hapësirën boshe brenda kornizës.
3. Mund t'i ngjyrosësh ato brenda ose të nënvizosh ato që të pëlqejnë veçanërisht.
4. Kur të kesh përfunduar, vendos librin tënd në mesin e klasës (mbi dysheme ose mbi bankë.)
5. Kur më shumë fëmijë të jenë gati, mund të ecni përreth dhe të hamendësoni se kujt i përket ajo gjë.
6. Ke hamendësuar saktë? Kontrollroje me shokët e tu.




Gjërat që pëlqej

Vizato apo shkruaj një listë me të gjitha gjërat, që pëlqen.

MOS shkruaj emrin tënd.

Shokët e tu duhet të hamendësojnë se kujt i përket piktura.



4 – DETYRA 2 ÇFARË NUK PËLQEJMË



60'

Detyra:

Renditi gjërat që të pëlqejnë dhe nuk të pëlqejnë. Krahasoje përfundimin tënd me renditjen e klasës.

Si punon:

Vetëm, më pas me të gjithë grupin, më pas me një shok.

Materiali:





- Libri
- Lapsa, ngjyra
- Foto të gjërave mbi dërrasë

Hapat:


1. Shiko foton në faqen pasuese. Cilat gjëra pëlqen? Cilat gjëra nuk pëlqen?
2. Vëju numrat gjërave, duke filluar prej asaj që të pëlqen më pak (numri 1), deri te ajo që të pëlqen më shumë (numri 6).
3. Kur të kesh përfunduar, shiko mësuesin.
4. Të njëjtat gjëra janë shkruar mbi tabelë.
5. Shko në tabelë dhe shkruaj 1 pikë afër tri gjërave që i pëlqen më pak.
6. Bashkë me mësuesin tënd gjej se cilat gjëra pëlqehen më pak nga klasa.
7. Bëj një diagram të përfundimeve.
8. Krahaso përfundimin e klasës dhe renditjen tënde. A ndryshojnë?



Çfarë nuk pëlqejmë



Diagrami i gjërave që nuk pëlqejmë



Cilët kafshë pëlqehen më pak në klasë?

Cilët kafshë pëlqen ti më pak?

4 - DETYRA 3

USHQIMI IM I PARAPËLQYER



Detyra:

Mendo për ushqimin tënd të parapëlqyer dhe vizatoje atë.

Si punon:

Vetëm

Materiali:

- Libri
- Lapsa, ngjyra



30'

Hapat:


1. Mendo se cili është ushqimi yt i parapëlqyer: për mëngjes, për drekë, për darkë dhe për zamër.
2. Vizatoje atë në faqen tjetër. Nëse nuk ha katër herë në ditë, mund të vizatosh se çfarë do të doje të kishe.
3. Ngjyrose ose emërtoje ushqimin.
4. Tregoja mësuesit tënd kur të kesh përfunduar.




Vizato ushqimin tënd të **parapëlqyer** mbi pjata. Ngjyrose apo emërtoje. Pyet një shok klase / shoqe klase se cili është ushqimi i tij / saj i parapëlqyer. Vizatoje atë mbi pjatën e fundit.




Ushqimi im i parapëlqyer për mëngjesin është:





Ushqimi im i parapëlqyer për drekën është:



Ushqimi i parapëlqyer i shokut tim / shoqes time është:



Ushqimi im i parapëlqyer për darkën është:



Shoku im / shoqja ime:

4 – DETYRA 4

LUAJ me SHOKËT e mi



60'

Detyra:

Mendo për lojërat e tua të parapëlqyera që luan me shokët e tu. Renditi ato në lojëra vajzash dhe djemsh.

Si punon:


Vetëm, më pas në grup.

Materiali:

- Libri
- Lapsa, ngjyra



Hapat:

1. Vizato në mesin e faqes një foto të lodrës apo lojës sate të parapëlqyer.
2. Në anën e majtë lodrës/lojës sate të parapëlqyer vizato një lojë apo lodër tipike djali.
3. Në anën e djathtë të lodrës/lojës sate të parapëlqyer vizato një vajzë.
4. Cila anë i përket lodrës/lojës sate? Është më shumë lodër/lojë vajzash apo djemsh?
5. Në një grup prej katër vetash, flisni për përfundimet.
6. A mund të jetë e kundërta? (p.sh. a mund që një lojë djali të jetë një lojë vajze? Nëse jo, pse?)




Lojëra për **DJEM** dhe për **VAJZA**

LODRA/LOJA ime e **PARAPËLQYER**



LODRA/LOJA
e **DJEMVE**



LODRA/LOJA
e **VAJZAVE**

Kujt i përket lodra/loja juaj?

Mund të gjeni lodra për të
dy gjinitë, djem dhe vajza?

4 – Detyrë shtëpie 5

Ky-kjo jam unë kur isha e/i vogël



Detyra:

Grumbullo informacione dhe gjëra për veten kur ishe i/e vogël.

Si punon:



Në shtëpi apo në një vend të qetë.

Materiali:

- Libri
- Lapsa, ngjyra
- Gjëra që i pëlqejnë kur ishe i/e vogël.

Hapat:

1. Shiko pyetjet dhe fotot.
2. Pyet prindërit e tu dhe pjesëtarët më të moshuar të familjes.
3. Shkruaj ose vizato se çfarë ke qenë.
4. Grumbullo gjërat që i pëlqejnë kur ishe i/e vogël. A ke edhe ndonjë fotografi?
5. Silli ato në shkollë.




Ky-kjo **JAM** unë kur isha i/e **VOGËL**

Çfarë pëlqeja të haja.




Çfarë pëlqeja të luaja.



Kënga që pëlqeja.



Fjala ime e parë.



Vendi im i parapëlqyer.



Gjërat që pëlqeja

(arushi im i parapëlqyer loja etj.)



4 – DETYRA 6

PARAQES VETEN, KUR ISHA I/E VOGËL



40'

Detyra:

Paraqit gjëra të rëndësishme për veten, kur ishe i/e vogël.

Si punon:


Me një shok, më pas me të gjithë grupin.

Materiali:

- Libri

Hapat:

1. Krahaso përgjigjet e tua me ato të një shoku a shoqeje. A ka gjëra të ngjashme që pëlqeni?
2. Rrini në grup prej katër vetash.
3. Njëri prej jush fillon dhe thotë një gjë për veten e tij/ e saj p.sh. "Çfarë më pëlqen të luaj..."
4. Më pas njëri pas tjetrit thoni se çfarë ju pëlqen të luani.
5. Më pas e ka dikush tjetër radhën. Ai/ajo zgjedh një gjë tjetër nga lista. I bëni dy gjiro në grup me këtë aktivitet.





FAMILJA ime



5 - DETYRA 1 FAMILJET JANË TË NDRYSHME



45'

Detyra:

Njih forma të ndryshme të familjes. Më pas vizaton familjen tënde.


Si punon:

Me të gjithë grupin, vetëm, pastaj me një shok.

Materiali:

- Libri
- Lapsa, ngjyra


Familja:



Hapat:

1. Rrini ulur në një rreth.
2. Mësuesi thotë:
"Tani të gjithë fëmijët që...
 - kanë një motër apo një vëlla... ju lutem të ngriheni!"
 - Kanë më shumë motra apo vëllezër
 - Jetojnë me babain dhe mamanë
 - Jetojnë me babain apo mamanë
 - Ndihen rehat në shtëpi
 - Nuk jetojnë me babanë apo mamanë, por me dikë tjetër
 - Do t'u pëlqente të kishin vetë një familje, kur të rriten
3. Të pëlqen kjo detyrë? Çfarë ishte për ty? N.q.s. ishte i vetmi që rrije i ngritur në rreth?
4. Shiko fjalët që të përgjigjen. Vendos se cili i përket familjes sate dhe cili jo.
5. Bëj një vizatim të familjes sate dhe shkruaj poshtë kush është kush.
6. Tregoja atë shokut tënd dhe krahasoni familjet tuaja.

Mamaja babai kushërira shoku halla/tezja gjyshja
xhaxhai/daja kumbari ndrikulla stërgjyshi stërgjyshja
motra vëllai macja televizori kali qeni



5 – DETYRA 2

PËRSE NJË FAMILJE ËSHTË E RËNDËSISHME



Detyra:

Mendo përse një familje është e rëndësishme dhe fol lidhur me të me një shok.

Si punon:


Vetëm, më pas me një shok.

Materiali:


- Libri
- Lapsa, lapsa me ngjyra

Hapat:

1. Shiko faqen tjetër.
2. Mendo përse një familje është e rëndësishme. Për shembull, "Unë mendoj që të kem një familje është e rëndësishme, sepse më bën të ndihem i sigurt" ose "unë mendoj që të kem një familje është e rëndësishme, sepse mund të mësoj shumë prej saj".
3. Shkruaj apo vizato në fluska.
4. Kthehu kah shoku yt dhe bisedo për idetë e tua.



Përse NJË FAMILJE është e rëndësishme



5 – DETYRA 3

DETYRAT NË FAMILJEN TIME



30'

Detyra:

Mendo për detyrat e ndryshme në familjen tënde dhe gjej se kush bën çfarë.

Si punon:

Vetëm, më pas më një shok.

Materiali:

- Libri
- lapsa

Hapat:

1. Shikoji fotografitë
2. Mendo se kush i kryen këto detyra në familjen tënde.
3. Shkruaj emrin e personit nën fotografi.
4. Zgjidh një ngjyrë për çdo person dhe ngjyros kutinë.
5. Cilën detyrë bën ti?
6. Vizato foton e detyrës sate nese ajo nuk është këtu.



Detyrat në familjen time



5 – DETYRA 4

FËMIJËVE U DUHEN RRËNJË, U DUHEN KRAHË



45'

Detyra:

E kupton përse shërbejnë rrënjët. E gjen se çfarë mund të bëjë familja jote për të "të dhënë krahë".

Si punon:

Me të gjithë grupin, më pas vetëm.

Materiali:


- Libri
- Lapsa

Hapat:

1. Shiko foton e pemës. E di përse pemëve u duhen rrënjë? Dhe përse zogjtë kanë krahë?
2. Diskuto bashkë:
 - Çfarë të duhet për t'u ndier mirë?
 - Çfarë të duket interesante? Për çfarë je i zoti?
 - Çfarë është menduar me "një fëmijë i duhen rrënjë dhe krahë"?
 - Mendo një situatë që të ka dhënë krahë.
 - Mendo një situatë që të ka dhënë rrënjë.
3. Mere foton e fëmijës. Ky-kjo je ti. Vizato kokën tënde mbi shpatulla.
4. Ngjyros rrënjët dhe shkruaj ose vizato brenda përse të duhen ato. Përse ndihesh mirë në familjen tënde?
5. Ngjyros krahët e fëmijës. Shkruaj ose vizato brenda se cilat janë pikat e tua të forta, çfarë të bën "të fluturosh" dhe për çfarë ëndërron.



Fëmijëve u duhen rrënjët,
u duhen krahë



5 – Detyrë shtëpie 5

Pema e familjes sime



Detyra:

Plotësoje pemën e familjes sate.

Si punon:


Vetëm, në shtëpi.


Materiali:

- Libri
- Lapsa

Hapat:

1. Shiko pemën e familjes.
2. Shkruaj emrin e familjes sate në fundin e pemës.
3. Shkruaj emrat e pjesëtarëve të familjes sate në pemë. Ti je në fund.
4. Kërkoju pjesëtarëve të familjes të të ndihmojnë.





5 – DETYRA 6 PARAQES PEMËN E FAMILJES SIME



30'

Detyra:

Paraqet pemën e familjes para klasës tënde.

Si punon:


I gjithë grupi punon bashkë.


Materiali:

- Pemët e familjes

Hapat:

1. Vendos librat me pemët e familjes në një rreth mbi dysheme.
2. Ec përreth dhe shiko të gjitha pemët e familjes.
3. Mësuesi do të fillojë me një lojë hamendësimi: Pema e cilës familje është kjo?
4. A ka ndryshime midis pemëve të familjes?
5. A e hamendësuan ata tuajën?







FESTOJMË BASHKË



6 – DETYRA 1

ÇFARË MUND TË PARAQESIM?



45'

Detyra:

Planifiko një festë për veten, prindërit e tu dhe mësuesit tuaj. Vendos se çfarë do të paraqesësh.

Si punon:

Vetëm, me një shok, me të gjithë grupin.

Materiali:

- Libri
- I gjithë materiali që është prodhuar.

Hapat:

1. Shiko të gjithë gjërat që ke prodhuar gjatë punës me librin FACE. Çfarë dëshiron të paraqesësh?
2. Mund të paraqesësh edhe një këngë, një kërcim apo ndonjë gjë tjetër. Fol për këtë me shokun tënd. Plotësoje në tabelë.
3. Sigurohu që gjithkush bën diçka.
4. Fol për këtë me të gjithë grupin.
5. Mësuesi juaj do të shkruajë se kush dhe çfarë do të paraqesë.



Dua të paraqes...

Me kë?

Materiali:

Me kë?

Materiali:

Me kë?

Materiali:

Ja disa shembuj:

- Ne këndojmë bashkë një këngë. • Ne tregojmë vizatimet tona.
- Ne tregojmë disa fletë pune. • Ne bëjmë një kërcim bashkë.
- Ne ftojmë mysafirët tanë për të bërë diçka bashkë.

Për shembull, një vizatim? Një pikturë? Një copë artizanati?
Një koleksion të gjërave që ne mund t'i bëjmë mirë?

6 – DETYRA 2 PRAKTIKOJMË (1)



45'

Detyra:

Praktiko se çfarë do të paraqesësh. Tregoja atë mësuesit tënd.

Si punon:

Vetëm, më pas me një shok.

Materiali:

- Të gjitha objektet dhe produktet e grumbulluara.

Hapat:

1. Fillo të praktikosh se çfarë do të paraqesësh. Përmbaju listës kontrolluese.
2. Gjej një hapësirë në klasë për ta bërë këtë.
3. Të duhet ndonjë material për këtë? Libri yt? Vizatime?
4. Kur ta kesh praktikuar, tregoja atë mësuesit tënd.
5. Përpiqu të përmirësosh paraqitjen tënde.



6 – DETYRA 3 SHKRUAJMË NJË FTESË



60'

Detyra:

Bashkë me mësuesin tënd skico një ftesë për prindërit e tu dhe të gjithë familjen.

Si punon:

Më të gjithë grupin, vetëm.

Materiali:

- Libri
- Lapsa, ngjyra
- Fletë letre (me ngjyra?)

Hapat:

1. Si rregull për të ftuar prindërit dhe familjen tuaj ju duhet një ftesë.
2. Diskuto bashkë me mësuesin se çfarë duhet të shkruhet në ftesë:
 - Si do ta quani festën tuaj?
 - Kur do të zhvillohet?
 - Ku do të zhvillohet?
 - Sa kohë do të zgjasë?
3. Shkruaj një version të ftesës në faqen tjetër.
4. Tregoja atë mësuesit tënd.
5. Tani, merr një fletë të re letre dhe shkruaj ftesën tënde me shumë mjeshtëri.
6. Zbukuroje atë.
7. Le ta firmosë mësuesi.
8. Merre në shtëpi dhe jepju prindërve të tu dhe familjes sate.



Ftesa ime



6 – DETYRA 4 PRAKTIKOJMË (2)



45'

Detyra:

Praktikojë sërish ftesën tënde. Tregoja atë mësuesit tënd dhe gjithë grupit.

Si punon:

Me një shok, më pas me të gjithë grupin.

Materiali:

- Materiali që ju duhet për paraqitjen tuaj.

Hapat:

1. Gjej një shok apo shoqe për paraqitjen tënde.
2. Praktikojë sërish me të.
3. Tani, praktikojë para gjithë grupit.
4. Merr informata kthyesë nga shokët e shoqet e klasës dhe nga mësuesi.



6 – Detyrë shtëpie 5

Ftoji prindërit e tu



Detyra:

Merre ftesën dhe ftoji prindërit e tu në festë. Kujtoju, se kur dhe ku zhvillohet.

Si punon:

Vetëm


Materiali:

- Ftesa

Hapat:


1. Mere në shtëpi ftesën e bërë vetë me dorë dhe jepju atë prindërve të tu.
2. Thuaju atyre se është festa e punës suaj në FACE në të cilën ata dhe ti kontribuat me gjëra të ndryshme.
3. Kujtoju atyre se kur dhe ku do të zhvillohet.





ÇFARË KAM MËSUAR
ÇFARË KEMI MËSUAR

7



7 – DETYRA 1

PYETJE DHE PËRGJIGJE PËR VETEN



30'

Detyra:

Bëhesh i vetëdijshëm për atë që ke punuar.

Si punon:

Vetëm

Materiali:

- Libri
- Lapsa

Hapat:

1. Gjatë muajve të fundit ke menduar shumë për veten.
2. Tani është koha t'u përgjigjesh disa pyetjeve nëse të kënaqi puna. Ktheu në faqen tjetër dhe gjithmonë shenjo fytyrën që është e saktë për ty.
3. Kur të kesh përfunduar, jepi qetësisht mësuesit librin me faqen e hapur.



Pyetje dhe përgjigje për veten



1.	Më pëlqeu të punoj me këtë libër.				
2.	Mësova gjëra të reja.				
3.	Më pëlqeu të punoj me shokët e mi.				
4.	E kuptoja se çfarë duhej të bëja.				
5.	Mund të bëj disa gjëra më mirë tani.				
6.	Më pëlqeu, kur duhej të vizatoja diçka.				
7.	Më pëlqeu kur duhej të shkruaja diçka.				
8.	Më pëlqeu kur duhej të flisja me njerëz të tjerë.				
9.	M'u duk e lehtë të punoja me librin.				
10.	E di se për çfarë jam i zoti.				
11.	E di se çfarë duhet të përmirësoj.				
12.	E di se për çfarë nuk jam i zoti.				
13.	E di se çfarë mendojnë të tjerët për mua.				
14.	E di se cilat janë pikat e mia të forta.				
15.	E di se çfarë do të thotë familja ime për mua.				
16.	Do të doja të punoja më shumë në pikat e mia të forta.				
17.	Do të doja të punoja më shumë me njerëz të tjerë.				
18.	Do të doja të kisha më shumë ndihmë nga familja ime.				
19.	Do të doja të kisha më shumë ndihmë nga shokët e mi.				
20.	Do të doja të punoja më shumë vetë.				

7 - DETYRA 2

MOMENTET E MIA TË LUMTURA DHE TË TRISHTUARA



30'

Detyra:

Ti bëhesh i vetëdijshëm për atë që ke punuar dhe identifikon ngritjet dhe zbritjet e tua.

Si punon:


Vetëm

Materiali:

- Libri
- Lapsa, ngjyra

Hapat:

1. Mendo sërish punën në liber.
2. Cili ishte momenti yt më i suksesshëm? Çfarë të bëri të lumtur?
3. A kishte ndonjë moment dështimi? A kishte diçka që të bëri të trishtuar?
4. Shkruaj apo vizato këto momente në faqen tjetër.



Momentet e mia
të LUMTURA dhe të TRISHTUARA



7 – DETYRA 3

DETYRA IME E PARAPËLQYER



25'

Detyra:

Ti bëhesh i vetëdijshëm për atë që ke punuar dhe identifikon detyrën tënde të parapëlqyer.

Si punon:


Vetëm, më pas me një shok.

Materiali:

- Libri
- Lapsa, ngjyra

Hapat:

1. Shiko të gjithë librin sërish. Lexo të gjitha gjërat që ke bërë dhe shiko të gjitha gjërat që ke vizatuar.
2. Çfarë të ka pëlqyer më shumë? Mund ta shkruash atë ose ta vizatosh.
3. Kur të kesh përfunduar, tregoja atë shokut tënd pranë.



Detyra ime e parapëlqyer

7 – DETYRA 4 ÇMIMI IM PERSONAL



30'

Detyra:

Skico një çmim për diçka që e ke bërë shumë mirë në librin FACE.

Si punon:

Vetëm, më pas me një shok.

Materiali:

- Libri
- Lapsa, ngjyra.

Hapat:

1. Mendo për kohën kur punoje me FACE. Për çfarë je krenar? Çfarë ke bërë mirë?
2. Skico një çmim për veten dhe vizatoje atë në faqen tjetër. Plotësoje se për çfarë është çmimi.
3. Vizato një çmim për shokun e klasës, për diçka që ka bërë. Paraqitja çmimit shokut.
4. Vendos librin në qendër të klasës.
5. Ec përreth dhe shiko të gjitha çmimet. Çfarë mendon?



★ Çmimi im personal ★

ÇMIMI

Data:

Emri:

Ë mora këtë çmim për:

Nënshkruar: _____

ÇMIMI

Data:

I jap këtë çmim:

Për:

Nënshkruar: _____

IA DOLE!
KE PUNUAR PËRGJATË
GJITHË LIBRIT.

Urime!



PËRSHTYPJET e mësuesIT TIM

Kjo faqe është e rezervuar për mësuesin/mësuesen. Ai/ajo do të shkruajë disa komente për ty dhe se si ishe kur punoje me këtë libër.

Ai/ajo mund po ashtu të flasë me ty për këtë gjë.

Data: _____ Nënshkrimi: _____

